

DEKLARATE PARAPRAKE ZGJEDHJET VENDORE 2015

Tiranë, 22 qershor 2015

Përmbledhje ekzekutive

KZLNDQ shpërndau në të gjithë vendin 1000 vëzhgues të paanshëm e të palëvizshëm, në bazë të një kampioni të rastësishëm dhe përfaqësues në rang kombëtar, si dhe në nivelin e bashkive të Tiranës, Shkodrës dhe Durrësit. Të dhënat cilësore të KZLNDQ-së kanë një nivel besueshmërie 95%, me marzh gabimi +/- 4% në nivel kombëtar, +/- 5% për Tiranën, +/- 5% për Durrësin, dhe +/- 5% për Shkodren. Shkalla e raportimit nga kampioni kombëtar ishte 100%, ndërkohë që për bashkitë e përzgjedhura si Tirana, Durrësi dhe Shkodra ishte mbi 95%. Të dhënat që mungojnë ishin të shpërndara proporcionalisht në të gjithë vendin dhe nuk komprometojnë besueshmërinë e të dhënave.

- Vëzhguesit e KZLNDQ nuk raportuan të meta procedurale dhe/ose shkelje të rëndësishme gjatë proceseve të Ditës së Votimit (hapjes së qendrave të votimit, procedurave të votimit dhe mbylljes së qendrave).
- Koalicioni ka vënë re shkelje të rënda të raportuara gjatë procedurave të ditës së zgjedhjeve në më pak se 4% të qendrave të votimit në mbarë vendin. Duke marrë parasysh marzhin e gabimit prej +/- 4% të kampionit tonë, kjo gjetje nuk ka rëndësi statistikore dhe nuk mund të interpretohet si tendencë në rang kombëtar, por si një numër incidentesh të izoluara.
- Shqetësimi më i madh gjatë procedurave të hapjes ishte mos shpërndarja nga ana e komisionerëve e kopjeve të procesverbaleve të vulave të sigurisë për vëzhguesit partiakë në 17 % të qendrave të votimit.
- Në rreth 85% të qendrave të votimit në rang vendi hapja e votimit u bë ose përpara orës 7 të mëngjesit ose në kohën e duhur.
- Pothuajse të gjitha qendrat e votimit në Shqipëri ishin të pajisura me materialet e nevojshme për nisjen e procesit të votimit, siç janë listat e votuesve, fletët e votimit dhe vulat zyrtare.
- Koalicioni raportoi, me shqetësim të madh, se në hapje të votimit rreth 10% e qendrave të votimit në Shqipëri nuk kishin përbërjen e plotë të anëtarëve të KQV-ve.
- Parregullsitë e lidhura me ushtrimin e të drejtës së votimit në rastet kur votuesit u lejuan të votonin pa qenë në Listën e Votuesve dhe pa patur një urdhër gjykate, që më pak se 3% ndërsa rastet në të cilat votuesit nuk u lejuan që të votojnë edhe atëherë kur paraqitën kartën e identitetit, pasaportën, kur emri i tyre ishte i shënuar në listën e zgjedhëse, apo kur e kishin një urdhër gjykate, ishte 4 % në rang vendi.



- Vëzhguesit e KZLNQQ vunë re se në një të katërtën e qendrave të votimit në rang vendi kishte raste kur votuesit nuk e gjenin emrin në listat e votuesve.
- Procedurat e timbrimit u respektuan në 93% të rasteve në rang vendi.
- I vetmi rast i rëndësishëm i mos-respektimit të procedurës së mbylljes kishte të bënte me lejin e votimit për votuesit që mbërrinin në qendrën e votimit pas orës 7 pasdite dhe një gjë e tillë ndodhi në tetë (8) % të qendrave të votimit në rang vendi.
- Në 93% të qendrave të votimit në rang vendi, vëzhguesit partiakë nuk kanë paraqitur ankesa zyrtare.
- Në 37% të qendrave të votimit në rang vendi, Komisionet e Qendrave të Votimit nuk kishin asnjë anëtare femër në përbërje të tyre dhe në vetëm 15% të Qendrave të Votimit në rang vendi kryetarja e komisionit të QV ishte femër.
- Koalicioni theksoi mangësi serioze në lidhje me garantimin e të drejtës për pjesëmarrje të plotë dhe në mënyrë efektive në zgjedhje të votuesve me aftësi të kufizuara – më shumë se 57% e qendrave të votimit në rang vendi nuk ishin të përshtatura për të qenë fizikisht të aksesueshme nga votuesit me aftësi të kufizuara dhe në 51% të qendrave të votimit në rang vendi votuesit me aftësi të kufizuara në shikim nuk mund të ushtronin të drejtën e tyre për të votuar në mënyrë të pavarur dhe të fshehtë për shkak të mungesës së fletëve të votimit në Braille.
- Të drejtat e vëzhguesve u respektuan në pothuajse të gjitha qendrat e votimit në të gjithë vendin.
- Vëzhguesit e dy partive më të mëdha PS dhe PD ishin të përfaqësuar në rreth 90% të qendrave të votimit, ndjekur nga LSI në rreth 80% të qendrave të votimit.

KZLNQQ dëshiron të falenderojë të gjithë vëzhguesit e saj për punën vullnetare të vëzhgimit të kryer gjatë zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015. Në fund të ditës, zhvillimi i mëtejshëm i demokracisë në Shqipëri do të përcaktohet nga pjesëmarrja e vazhdueshme aktive e qytetarëve në proceset politike, në shifra të mëdha e në mënyra të ndryshme.

Hyrje

Zgjedhjet Vendore të 21 qershorit 2015 janë zgjedhjet e para të zhvilluara në Shqipëri që kur Bashkimi Europian (BE) i dha Shqipërisë, në qershor 2014, statusin e vendit kandidat. Administrimi demokratik i zgjedhjeve shihet si një pikë e rëndësishme në hapjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, si një shtet kandidat zyrtar. Ato janë gjithashtu zgjedhjet e para lokale të zhvilluara në kuadër të reformës së re administrative territoriale (RAT) të miratuar nga Kuvendi në vitin 2014. Me reformën e re zvogëlohet ndjeshëm numri i njësive qeverisëse vendore, nga 373 në 61 të tilla



Në 21 qershor 2015, 3,372,471¹ qytetarë shqiptarë patën mundësinë të bëjnë zgjedhjet e tyre politike duke votuar në 5,301 Qendra Votimi në të gjithë vendin. Qytetarët zgjedhën 61 kryetarë bashkish dhe 61 këshilla bashkiakë të përbërë nga 1595 këshilltarë për bashkitë e reja të zgjeruara, të cilat do të kenë pushtet më të madh dhe burime më të shumta për të adresuar nevojat e përditshme të qytetarëve.

Kryetarët e bashkisë zgjidhen sipas një sistemi të drejtpërdrejtë, ku kandidati me numrin më të madh të votave përcaktohet fitues. Këshilltarët bashkiakë zgjidhen nëpërmjet një sistemi proporcional përfaqësues me lista të mbyllura. Partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e pavarur që plotësojnë kriteret e parashikuara në legjislacion mund të kandidojnë në zgjedhje. Votimi i përgjithshëm dhe i barabartë garantohet për qytetarët mbi 18 vjeç.

Procesi zgjedhor administrohet nga administrata zgjedhore në tre nivele: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i përbërë nga 7 anëtarë; 90 Komisione Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) të përbërë nga 720 anëtarë; dhe 5,301 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV) me nga 7 anëtarë secili. Përveç këtyre, ka 90 Qendra të Numërimit të Votave (QNV), një për çdo Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ) ku Grupet e Numërimit (GN) numërojnë votat në nivelin e ZAZ-së. Me përjashtim të Kryetarit të KQZ, të gjithë anëtarët e tjerë të niveleve të administrimit zgjedhor emërohen nga aktorët politikë.

Gara kryesore politike në të gjithë vendin u zhvillua ndërmjet kandidatëve të Partisë Socialiste (PS) dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI) – dy partitë kryesore politike në pushtet që drejtojnë Aleancën për Shqipërinë Europiane (ASHE) – dhe kandidatëve të Partisë Demokratike (PD), partia më e madhe opozitare, e cila drejton Aleancën Popullore për Punë dhe Dinjitet (APPD). Në të gjithë vendin kandiduan për kryetarë bashkish katërmëdhjetë (14) kandidatë të pavarur (të propozuar nga populli). Në total, ishin 158 kandidatë për kryetarë bashkish, nga të cilët 16 (10.1 %) qenë gra, çka flet për mundësi të kufizuara për gratë për të garuar për pozicionin më të lartë në bashki. Numri i përgjithshëm i kandidatëve për këshillat bashkiakë ishte 36,341², nga të cilët 17,137 (49.3%) ishin gra. Periudha zyrtare e fushatës zgjedhore 30 ditore filloi më 22 maj dhe përfundoi në 19 qershor, duke lënë një ditë heshtje zgjedhore 24 orë përpara dites së zgjedhjeve.

¹ Burim: Komisionit Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Shikoni: <http://results.cec.org.al/>

² Burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/Barazia_gjinore/kuota_gjinore_kandidimet_Zgjedhjet_%20Vendore_%202015.pdf



Misioni dhe metodologjia e vëzhgimit e KZLNDQ

Metodologjia e KZLNDQ për vëzhgimin e zgjedhjeve përfshin tërësinë e procesit zgjedhor, duke përfshirë vëzhgimin e periudhës para-zgjedhore, ditën e votimit, procesin e numërimit të votave dhe zgjidhjen e ankimeve paszgjedhore dhe procesin e certifikimit të votës.

Vëzhgimi i situatës parazgjedhore

KZLNDQ caktoi 90 Vëzhgues Afatgjatë (VAGJ), të pavarur e të trajnuar, në të gjithë 90 Zonat e Administrimit Zgjedhor (ZAZ) për të vëzhguar periudhën parazgjedhore - duke u përqendruar në punën e administratës zgjedhore, fushatën e partive politike dhe kandidatëve të pavarur, si dhe mundësinë e abuzimit me burimet dhe institucionet publike për qëllime elektorale.

KZLNDQ raportoi për një fushatë në përgjithësi të qetë edhe pse vëzhgoi, mes gjetjeve të tjera të hollësishme, se kandidatët politikë e nisen fushatën shumë përpara datës zyrtare të 22 majit. Heshtja një ditore zgjedhore një ditë para zgjedhjeve u respektua.

Vëzhgimi i Ditës së Zgjedhjeve

Vëzhguesit e KZLNDQ u caktuan sipas një kampioni përfaqësues statistikor të qendrave të votimit në të gjithë vendin duke e mundur KZLNDQ të vlerësojë mbarëvajtjen e hapjes, votimit dhe mbylljes së qendrave të votimit si një të tërë.

KZLNDQ, duke përdorur metodologjinë e vëzhgimit të mbështetur në statistika (SBO), caktoi si vëzhgues të palëvizshëm 500 vëzhgues të trajnuar, të certifikuar dhe të akredituar në një kampion të rastësishëm dhe përfaqësues prej 500 Qendrash Votimi. KZLNDQ mbikampionoi në bashkitë e Tiranës, Shkodrës dhe Durrësit me 500 vëzhgues shtesë, duke e cuar kampionin në këto bashki në: 270 në Tiranë, 150 në Shkodër dhe 180 në Durrës.

Kjo metodologji i mundësoi Koalicionit të ekstrapolonte gjetjet e vëzhgimit të drejtpërdrejtë për të gjithë vendin, si dhe për tre bashkitë e përmendura më sipër. Kjo do të thotë se Koalicioni ishte në gjendje të vlerësonte cilësinë e procesit zgjedhor në të gjithë vendin dhe jo vetëm në qendrat e votimit të mbuluara nga vëzhguesit e palëvizshëm. Të dhënat cilësore të KZLNDQ-së kanë një nivel besueshmërie 95%, me marzh gabimi +/- 4% në nivel kombëtar, +/- 5% për Tiranën, +/- 5% për Durrësin, dhe +/- 5% për Shkodrën.

Vëzhguesit e KZLNDQ-së vlerësuan procesin e votimit në terësi, nga hapja e deri në finalizimin e procedurave të mbylljes së qendrave të votimit. Informacioni i KZLNDQ mbi mbarëvajtjen e ditës së zgjedhjeve dhe pjesëmarrjes në votim është i saktë brenda marzhit të gabimit.



Puna e vëzhgimit të KZLNDQ-së u mbështet nga 63 koordinatorë terreni, 50 operatorë në qendren operative dhe ekspertë zgjedhorë në zyrat e KZLNDQ-së.

Vëzhgimi i procesit të numërimit

KZLNDQ ka vijuar vëzhgimin me mbulimin e nëntëdhjetë (90) Vendeve të Numërimit të Votave (VNV) në të gjithë vendin, duke matur cilesinë dhe transparencën e procesit të numërimit. Vëzhguesit e KZLNDQ do të vëzhgojnë të gjithë procesin e numërimit, duke filluar nga marrja në dorëzim e materialeve nga KZAZ-të e deri në shpalljen e rezultateve. KZLNDQ nuk vëzhgoi procesin e transportimit të kutive të votimit nga qendrat e votimit te vendnumërimet e votave.

Komunikimi

KZLNDQ ka informuar rregullisht publikun mbi zhvillimet para-zgjedhore. Ky raport paraprak fokusohet në proceset e ditës së zgjedhjeve (hapja, votimi dhe mbyllja e qendrave të votimit). KZLNDQ do të publikojë një raport përfundimtar ku do të vleresojë procesin e zgjedhjeve vendore në tërësi, përfshirë numërimin dhe tabulimin e votave, zgjidhjen e ankimeve dhe certifikimin e votave.

Gjetjet mbi Ditën e Zgjedhjeve

KZLNDQ-ja dëshiron të theksojë se Dita e Zgjedhjeve është themelore por jo tregues i plotë i procesit zgjedhor. Cilësia e zgjedhjeve nuk mund të vlerësohet duke u bazuar vetëm në gjetjet e Ditës së Zgjedhjeve. Si rrjedhim, ky raport paraprak përqendrohet tek cilësia e proceseve të Ditës së Zgjedhjeve, ndërkohë që vlerësimi i cilësisë në tërësi i procesit zgjedhor, do të vlerësohet në raportin përfundimtar.

Shkalla e raportimit nga kampioni kombëtar ishte 100%, ndërkohë që për bashkitë e përzgjedhura si Tirana, Durrësi dhe Shkodra ishte mbi 95%. Të dhënat që mungojnë ishin të shpërndara proporcionalisht në të gjithë vendin dhe nuk komprometojnë besueshmërinë e të dhënave.

Hapja e Qendrave të Votimit (QV-ve)

Procedura e hapjes së qendrave të votimit në përgjithësi pati një ecuri të rregullt me përjashtim të disa vonesave në hapjen e disa qendrave si dhe një numri të vogël problemesh proceduriale.

Vëzhguesit e KZLNDQ-së nuk raportuan mangësi të rënda proceduriale përveç mos shpërndarjes nga ana e komisionerëve të kopjeve të procesverbaleve të vulave të sigurisë të vëzhguesit e partive, në 17% të qendrave të votimit. Procesverbalet e vulave të sigurisë lejojnë për vërtetimin e integritetit të kutisë së votimit kur ajo merret në KZAZ. Një trend i



lartë u vu re në bashkitë e Tiranës dhe Durrësit në masën 22%, ndërkohë që situata në Shkodër është ndjeshëm më e mirë, me vetëm 7% të qendrave të votimit të cilat u përballen me këtë problem. Shpërndarja e procesverbaleve të vulave të sigurisë është e detyrueshme dhe nëse ato nuk shpërndahen siç duhet, pengon vëzhguesit partiakë për të verifikuar sigurinë e vetë vulave më vonë, në procesin e numërimit dhe ankimimit. Kjo situatë mund të lëkundë besimin në rezultatet zgjedhore, në veçanti për kandidatët e pavarur si dhe për partitë politike që nuk kanë komisionerë.

Në rreth 85% të qendrave të votimit në mbarë vendin, hapja e votimit filloi ose pak përpara orës 7:00 të mëngjesit ose në orarin e duhur. Megjithatë, në Tiranë dhe Durrës, 79% dhe 77% e qendrave të votimit respektivisht u hapën përpara orës 7 të mëngjesit ose në orar (7.00), ndërkohë që në Shkodër, numri i qendrave të votimit që u hapën përpara orës 7 të mëngjesit apo në orarin e caktuar (7.00), është në nivelin 71%, që është ndjeshëm më e ulët se përqindja në nivel kombëtar.

Pothuajse të tëra qendrat e votimit në Shqipëri, ishin të pajisura me materialet e nevojshme për fillimin e procesit të votimit, si listat e votuesve, fletët e votimit si dhe vulat zyrtare, gjë që është në linjë me trendin e vënë re në bashkitë e Tiranës, Shkodrës dhe Durrësit. Koalicioni raportoi me shqetësim të madh që 10% e qendrave të votimit nuk ishin me përbërje të plotë në hapjen e qendrës së votimit. Kjo përqindje është paksa më e lartë në Tiranë, me 16% të qendrave të votimit, pasuar me 12% në Durrës, ndërkohë që situata në Shkodër ishte disi më e mirë, me 8% të qendrave të votimit me këtë problem.

Vëzhguesit e KZLNDQ raportuan shkelje të rënda, përfshi këtu vazhdimin e fushatës përbrenda rrezes prej 150 m përpara qendrave të votimit, në më pak se 1% të tyre. Kjo gjetje nuk është me peshë të madhe statistikore pasi është në nivelin e marzhit të gabimit dhe mund të trajtohet si incident i izoluar. I njëjta tendencë vërehet në bashkitë e Tiranës, Durrësit dhe Shkodrës gjatë procedurës së hapjes.

Nga pikëpamja procedurale, pak më shumë se gjysma e qendrave të votimit në mbarë vendin, respektuan të gjitha procedurat kryesore e të detyrueshme³ të hapjes së votimit, të vëzhguara nga vëzhguesit e KZLNDQ-së. Një trend i ngjashëm u vërejt në bashkitë e Tiranës, Shkodrës dhe atë të Durrësit.

Procedurat e Votimit

KZLNDQ vërejt se procedurat e votimit u kryen në përgjithësi në mënyrë paqësore nëpër qendrat e votimit të mbarë vendin, pa parregullsi të mëdha që do të mund të ndikonin tek

³Monitoruesit e KZLNDQ vëzhguan procedurat e mëposhtme të hapjes: hapjen në kohë; inspektimin e kutisë që duhet të jetë e boshatisur dhe e vulosur me kodet e sigurisë; nëse vulat ishin të regjistruara në protokollin e vulave; nëse kopjet e protokolleve të vulave u ishin shpërndarë komisionerëve dhe vëzhgueseve të partive; nëse të tëra QV-të ishin të pajisura me materialet e nevojshme; si dhe praninë e pjesëtarëve të KQV-ve.

rezultati i zgjedhjeve. Me përjashtim të disa incidenteve të izoluara, votuesit në përgjithësi patën mundësinë të votonin në një atmosferë pa frikësim apo dhunë brenda qendrave të votimit.

Shkeljet lidhur me ushtrimin e të drejtës së votuesve, ku një votuesi i cili është i regjistruar në listën e votuesve apo disponon një urdhër gjykate dhe paraqet një dokument të vlefshëm identifikimi, iu refuzua gjithësesi e drejta për të votuar, u vunë re në më pak se 4% të qendrave të votimit. Dhe e kundërta, rastet kur votuesve, të cilët nuk e kishin dokumentacionin e kërkuar dhe as nuk ishin në listën e votuesve e as nuk dispononin një vendim gjykate, iu lejua gjithësesi të votonin, u vëzhguan në më pak se 3% të qendrave të votimit në mbarë vendin.

Vëzhguesit e KZLN-DQ-së vërejtën se në pothuajse një të katërtën e qendrave të votimit në mbarë vendin, pati raste ku votuesit nuk gjenin emrin e tyre në listën e votuesve. Tetëmbëdhjetë (18) përqind e qendrave të votimit në mbarë vendin patën deri në pesë raste individuale. Shtatë (7) përqind e qendrave të votimit raportuan gjashtë ose më shumë raste individuale. Në Tiranë, Shkodër dhe Durrës votuesit nuk gjetën emrat në listat e votuesve respektivisht në 32%, 31%, 38% të qendrave të votimit. Shkalla e rasteve individuale në tre bashkitë e përfshira, gjithashtu reflekton këtë tendencë të nivelit kombëtar. Njëzetëdy (22) përqind e qendrave të votimit në Tiranë dhe Shkodër kishin deri në pesë raste individuale, të ndjekura nga Durrësi që regjistroi 26%. Trembëdhjetë (13) përqind e qendrave të votimit në Durrës patën gjashtë apo më shumë raste individuale, të ndjekura nga Tirana dhe Shkodra me nga 10% secila.

Procedurat e shënimit me bojë timbruese u respektuan në 93% të rasteve në mbarë vendin, dhe i njëjti trend u ndoq në bashkitë e Tiranës, Durrësit dhe Shkodrës. Për rrjedhojë, nuk mund të deklarojmë se kjo procedurë u ndoq plotësisht; megjithëkëtë, një përqindje e tillë e lartë tregon se mos-ndjekja e kësaj procedure, nuk do mund të ndikonte në rezultatet e përgjithshme zgjedhore.

Vëzhguesit e KZLN-DQ-së raportuan shkelje të rënda gjatë procedurave të votimit në më pak se katër përqind (4%) të qendrave të votimit në rang vendi. Një trend i ngjashëm u vërejt në bashkitë e Tiranës, Shkodrës dhe Durrësit. Duke marrë parasysh marzhin e gabimit të kampionit tonë që është +/- 4%, kjo gjetje nuk ka rëndësi statistikore, dhe reflekton incidente të izoluara, të vëzhguara në zona gjeografikisht të shpërndara. Incidentet përfshijnë⁴ pezullimin e votimit për më shumë se 30 minuta, fotografimin e fletëve të votimit, bërjen e fushatës zgjedhore brenda ose në afërsi të qendrave të votimit (përfshirë materialet propagandistike apo partiake), votimin më shumë se një herë, dhe votimin familjar.

⁴ QV Durrës 14202 dhe QV 14521, Elbasan QV 2245, Përrenjas QV 2791 Fier QV 3146, QV 3034, Gjirokastrë 4120, Korçë QV 3979, QV 3740, QV 4103, dhe QV 3868, Shkodër QV 89 dhe QV 243, Tiranë QV 2115, QV 2082, QV 17281, QV 19201 dhe QV 2061 dhe Vlorë QV 4585 dhe QV 4598.



Procedurat e mbylljes

Procedurat e mbylljes së qendrave të votimit u kryen në përgjithësi në mënyrë të rregullt në mbarë vendit, pa parregullsi të mëdha të cilat do mund të ndikonin në rezultatin e zgjedhjeve. Vëzhguesit e KZLN-DQ-së raportuan shkelje të rënda - përfshi këtu praninë e personave të paautorizuar në qendrat e votimit, pezullim të procedurës përmblylëse për më shumë se 30 minuta, si dhe shkelje të tilla procedurale si për shembull mos sigurimi dhe vulosja e kutive të votimit përpara transportimit të tyre si dhe vendosja e procesverbalit të vulosjes - në më pak se 1% të qendrave të votimit në rang vendi. Kjo nuk përbën një gjetje statistikisht të rëndësishme dhe nuk mund të interpretohet si një trend në shkallë vendi, por vetëm si një incident i izoluar. I njëjti trend u vërejt edhe në bashkitë e Tiranës, Durrësit dhe Shkodrës.

Një shkelje procedurale e rëndësishme gjatë mbylljes ishte se në tetë përqind (8%) të qendrave të votimit në të gjithë vendin u lejuan të votonin ata qytetarë që mbërritën në qendrën e votimit pas orës 19:00.

Vëzhguesit e partive politike kryen ankime në 7% të qendrave të votimit në të gjithë vendin. Partia Socialiste dhe Partia Demokratike bënë ankime në 5% të qendrave të votimit. Lëvizja Socialiste për Integrim u ankua në 3% të qendrave të votimit. Bashkitë e Tiranës dhe Durrësit e pasqyruan këtë prirje të nivelit kombëtar, duke shënuar ankime në 3% dhe 5% të qendrave të votimit përkatëse. Në Shkodër u bënë ankime me shkrim në 17% të qendrave të votimit.

Gratë dhe Votuesit dhe Aftësi të Kufizuara

37% të komisioneve të qendrave të votimit në të gjithë vendin nuk kanë pasur asnjë anëtare femër. Në Durrës dhe Shkodër, në 20% dhe 40% të qendrave të votimit përkatëse, nuk ka pasur anëtare femra.

Një grua mbulonte pozicionin e kryetares në vetëm në 15% të qendrave të votimit në të gjithë vendin. Shkodra dhe Durrësi pasqyrojnë të njëjtën prirje si në nivel kombëtar, por në Tiranë situata paraqitet pothuajse dyfish më e mirë se mesatarja kombëtare, duke patur kryetare femra në 29% të komisioneve të qendrave të votimit.

Koalicioni vuri në dukje mangësi serioze dhe të përhapura në të gjithë vendin kur bëhej fjalë për t'u mundësuar personave me aftësi të kufizuara të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhje. Më shumë se 57 përqind e qendrave të votimit në të gjithë vendin nuk kishin infrastrukturën e nevojshme për t'u mundësuar akses votuesve me aftësi të kufizuara. E njëjta veçori u vëzhgua edhe në Tiranë, Shkodër dhe Durrës. Koalicioni vë në dukje se, në 51% të qendrave të votimit në të gjithë vendin, votuesit me probleme shikimi nuk mundën të ushtronin të drejtën për të votuar në mënyrë të pavarur dhe të fshehtë.



E Drejta e Vëzhguesve për të Vëzhguar në Qendrat e Votimit

KZLNDQ vë në dukje me kënaqësi se u respektua e drejta e vëzhguesve të pavarur për të qenë të pranishëm dhe për të vëzhguar mbarëvajtjen e punës në qendrat e votimit pothuajse në të gjithë vendin. Në 99 % të qendrave të votimit, vëzhguesit ushtruan të drejtën e tyre siç përcaktohen në Kodin Zgjedhor. Pati incidente të izoluara ku kjo e drejtë nuk u respektua, kryesisht gjatë procedurave të mbylljes. Vëzhgimet në Tiranë, Durrës dhe Shkodër pasqyruan të njëjtën prirje me të gjithë vendin.

Vëzhguesit e Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike qenë të pranishëm në pothuajse 90% të qendrave të votimit. Lëvizja Socialiste për Integrim pati vëzhgues në pothuajse 80% të qendrave të votimit. E njëjta prirje u vu re në bashkitë e Tiranës dhe Shkodrës, ndërsa në Durrës të tre partitë patën vëzhgues në 95% të qendrave të votimit.

Rreth Koalicionit

Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e Demokraci të Qendrueshme (KZLNDQ) është një organizatë e pavarur, jopartiake, e krijuar për të promovuar pjesëmarrjen qytetare në zgjedhje dhe për të siguruar demokracinë e qëndrueshme. KZLNDQ përqendrohet në çështje që ndikojnë në zbatimin e të drejtave të njeriut, çështjet e barazisë gjinore dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

KZLNDQ ka nënshkruar Deklaratën e Parimeve Globale për Vëzhgim të Paanshëm të Zgjedhjeve dhe Monitorim nga Organizatat e Qytetarëve si dhe Kodin e saj të Sjelljes të GDNEM (Rrjeti Global I Vëzhguesve Vendorë për Monitorimin e Zgjedhjeve) që parashtron qartësisht deklaratën e parimeve dhe kodin e sjelljes për monitorimin e pavarur të zgjedhjeve nga organizatat qytetare. Metodologjia e vëzhgimit të zgjedhjeve të KZLNDQ është në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të përfshira në dokumentet ndërkombëtare, si Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.

KZLNDQ, nga 6 qershori 2015, përbëhet nga 30 organizata partnere dhe qindra vullnetarë në të gjithë Shqipërinë që ndihmojnë KZLNDQ-në për vëzhgimin e Zgjedhjeve Vendore të 21 qershorit 2015.

Projekti për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Vendore mbështetet nga Assist Impact nëpërmjet fondeve të USAID-it dhe zbatohet me asistencën teknike të Institutit Demokratik Amerikan, NDI.

Për hollësi dhe gjetje të tjera, vizitoni:

Internet: www.kzln.org.al

Facebook: [Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme](#)

Twitter: [KZLN_CFFE_Albania](#)

